VENDIM
Nr. 102, datë 24.6.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK LUNDRUES MBI REZERVUARIN E HEC "BANJA", ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1 germa "a" dhe të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të "Rregullores të organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 75/7 prot., datë 16.6.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Statkraft Renewables Albania' sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC "Banjë", me kapacitet të instaluar 2 mw",

konstatoi se:

- Shoqëria "Statkraft Renewables Albania" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 753 prot., datë 9.6.2020, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC "Banjë", me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Shoqëria "Statkraft Renewables Albania" sh.p.k. është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në datën 6.8.2018, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

- Shoqëria "Statkraft Renewables Albania" sh.p.k. është një subjekt përfaqësues në cilësinë e mbajtësit të miratimit, i cili ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën me nr. 6077 rep., nr. 1657 kol., datë 19.12.2019, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC "Banjë", Bashkia Cërrik, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me miratimin përfundimtar nr. 4657/2 prot., datë 31.5.2019, ka miratuar ndërtimin e centralit fotovoltaik lundrues dhe veprave të tij ndihmëse mbi rezervuarin e HEC "Banjë", Bashkia Cërrik, qarku Elbasan nga shoqëria "Statkraft Renewables Albania" sh.p.k., me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "Statkraft Renewables Albania" sh.p.k., në bazë të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të ndryshuar, rezulton:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c" dhe "f") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3, germat "a", "b", "c" dhe "d"; pika 4.1.4 germat "a", "b", "c" dhe "d"; pika 4.1.5, germa "b") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.4.4, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni i parashikuar në nenin 9, pika 4.4.5, germa "a",)Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose të shpërndarjes): plotësuar. Subjekti ka depozituar pranë ERE-s "Miratim pikë lidhjeje, centrali fotovoltaik lundrues" me nr. 4603/3 prot., datë 2.4.2019, për shoqërinë "Statkraft Renewables Albania" sh.p.k. Në këtë miratim përcaktohet se ky central fotovoltaik lundrues do të lidhet me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet linjës 35 kV, që lidh Nënstacionin Banjë me Nënstacionin Mjekës. Lidhja do të realizohet nëpërmjet një linje 35 kV të re me përcjellës ACSR dhe pajisjet përkatëse elektrike nga centrali deri te pika e lidhjes që do të ndërtohet nga investitori. Matja e energjisë do të realizohet me matës statik me dy drejtime për energjinë reaktive sipas kërkesave të kodit të matjes.

- Dokumentacioni i parashikuar në neni 9, pika 4.4.5, germa "b", (Leje mjedisore nga organet përkatëse): pa plotësuar. Në vijim do t'i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE lejen mjedisore të lëshuar për këtë central.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe nenit 5 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.

- Duke qenë se nga studimi i fizibilitetit të hartuar për Centralin Fotovoltaik lundrues të shoqërisë "Statkraft Renewables Albania" sh.p.k., rezulton se jetëgjatësia e një paneli është jo më shumë se 25 vjet, kohëzgjatja e licencës që ERE mund të miratojë për këtë subjekt nuk mund të jetë më shumë se 25 vjet.

- Shoqëria "Statkraft Renewables Albania" sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit, në zbatim të rregullores "për Procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të ndryshuar.

Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", ta paraqesë atë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, BORDI i ERE-s

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Statkraft Renewables Albania" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC "Banjë", me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti